



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-453/01-0020109-2/25 dt. 10-04-2025  
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren MF - Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe pas shqyrtimit të Kërkesës Nr. 01-453/01-0020109/25, dt. 07.04.2025 për Lejimin e Shpalljes Publike për Financim Publik të OJQ-ve në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian, për Mbështetje Financiare për Projektet në fushën e Turizmit dhe Mjedisit për Thirrjen e Parë Publike për Vitin 2025, Kryetari i Komunës sjell këtë:

#### V E N D I M

(Për Shpalljen e Thirrjes Publike për Mbështetje Financiare Publike për Projekte/Programe të OJQ-ve në fushën e Turizmit dhe Mjedisit për Thirrjen e Parë Publike për Vitin 2025)

1. **Miratohet** Kërkesa Nr. 01-453/01-0020109/25, dt. 07.04.2025 për lejimin e Shpalljes Publike për Financim Publik të OJQ-ve në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian, për projekte që kanë të bëjnë me fushën e Turizmit dhe Mjedisit për Thirrjen e Parë Publike për Vitin 2025, në bazë të Thirrjes Publike.
2. Për implementimin e Thirrjes Publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF - Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Mbështetja Financiare Publike për Projektet/Programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Komunës së Mitrovicës së Jugut, kodi Subvencione dhe Transfere, në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian.
4. Mjetet financiare të cekura në nenin 3 (tre) të këtij Vendimi do të shpërndahen në bazë të Thirrjes Publike për financimin e Projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e Thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
5. Dokumentacioni për zbatimin e Thirrjes Publike sipas këtij Vendimi, përfshinë;
  - 5.1. Teksti i Thirrjes Publike;
  - 5.2. Udhëzimet për Aplikantët;
  - 5.3. Formularët e Aplikimit;
  - 5.4. Forma për Vlerësimin e Cilësisë së Projekteve;
  - 5.5. Format për Raportimin e Zbatimit të Projektit.
6. Formularët e aplikimit të cekur në nenin 5 (pesë) të këtij Vendimi janë;
  - 6.1. Forma e Përshkrimit të Programit apo Projektit;

- 6.2. Forma e Buxhetit të Programit apo Projektit;  
6.3. Forma e Deklarimit të Mungesës së Fondeve të Dyfishta;  
6.4. Deklarata e Partneritetit (nëse është e aplikueshme);  
6.5. Forma e Deklaratës së Programeve apo Projekteve të OJQ-ve të Financuara nga Burimet Publike;  
6.6. Deklarata për Aktivitetet e Kontraktorit e përmendur në përshkrimin e Projektit që janë të njohur me Programin ose Projektin dhe Pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).
7. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në nenin 5 (pesë) të këtij Vendimi janë;  
7.1. Forma e Kontratës për Financimin e Programit apo Projektit;  
7.2. Formulari për Përgatitjen e Raportit Narrativ për Projektin apo Programin;  
7.3. Formulari për Përgatitjen e Raportit Financiar të Programit apo Projektit.
8. Thirrja Publike dhe Dokumentacioni për zbatimin e Thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në web faqen e komunës.
9. Në përputhje me Rregulloren MF - Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe udhëzuesit për aplikantët, Kryetari i Komunës do të formojë Komisionin Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve, si dhe për verifikimin e kushteve të përcaktuara me thirrje publike.
10. Komisioni i lartcekur do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit.
11. Komisioni Vlerësues bazë për punën e tij do të ketë Rregulloren MF - Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe Manualin mbi implementimin e kësaj rregulloreje.
12. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian është e obliguar të njoftojë përfituesit për kohën dhe datën e nënshkrimit të kontratave.
13. Përgjegjës për zbatimin e këtij Vendimi është Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian.
14. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Shtojcë:**

- 1x1 Kërkesa Nr. 01-453/01-0020109/25, dt. 07.04.2025 e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian;  
1x1 Thirrja Publike e DEZHTIE-së me Materialin Përcjellës.

**Ti dorëzohet:**

- 1x1 Kryetarit të Komunës  
1x1 Zyrës Ligjore  
1x1 Zyrës për Informim  
1x1 Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian  
1x1 Arkivit



Kryetari i Komunës

Bledi HAMZA